

VENDIM
Nr.594, datë 18.8.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, të zbritet fondi prej 4 098 290 (katër milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë.

b) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, të shtohet fondi prej 4 098 290 (katër milionë e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha